REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:081169
Datë: 27.01.2023
Numri i dokumentit: 03910979
CP.nr.140/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në lëndën përmbarimore të kreditorëve B.K nga Prizreni, B.Q nga Gjakova, B.S nga Gjakova, D.Ll nga Gjakova dhe M.V nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, të cilët sipas autorizimeve i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër debitores Komuna e Gjakovës – DKA në Gjakovë, për shkak kompensimin të shpërblimit jubilar, me vlerë të kredisë 2,189.17 euro, jashtë seancës, me 27 janar 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore, e udhëhequr sipas shenjës CP.nr.140/22, e iniciuar të kreditorëve B.K nga Prizreni, B.Q nga Gjakova, B.S nga Gjakova, D.Ll nga Gjakova dhe M.V nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, kundër debitores Komuna e Gjakovës – DKA në Gjakovë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitorja.

A r s y e t i m

Kreditorët e përmbarimit B.K nga Prizreni, B.Q nga Gjakova, B.S nga Gjakova, D.Ll nga Gjakova dhe M.V nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit ekzekutiv aktgjykimit C.nr.480/20 datë 14.12.2021 i marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, i ekzekutueshëm nga 28.01.2022, kundër debitores Komuna e Gjakovës – DKA në Gjakovë dhe i kanë propozuar kësaj gjykatë që të lejoj përmbarimin për shkak kompensimin të shpenzimeve të shpërblimeve jubilare, me vlerë të kredisë 2,189.17 euro të debitorit ndaj këtu kreditorit.

Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, me aktvendimin CP.nr.140/22, datë 22.03.2022, ka lejuar përmbarimin ndaj debitores Komuna e Gjakovës – DKA në Gjakovë.

2022:053262

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.nr.140/22, datë 22.03.2022, ka marrë formën e prerë me datë 16.11.2021, gjykata ka nxjerrë urdhër për ekzekutim, me të cilin e ka urdhëruar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitores Komuna e Gjakovës – DKA, të bëjë bartjen e mjeteve sikurse në urdhrin për ekzekutim CP.nr.140/22, datë 09.09.2022, avokatit Ilir Rogova.

I autorizuari i kreditorit, me parashtresën e datës 03.11.2022, ka njoftuar gjykatën se Thesari i Kosovës, ka vepruar sipas urdhrit të Gjykatës duke i ka ekzekutuar mjetet për destinim për kreditoret, duke theksuar se procedura ka përfunduar në tërësi.

Meqenëse kreditori përmes të autorizuarit të tij e ka njoftuar Gjykatën, se Thesari i Kosovës ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, në të cilin parashihet se *"Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore",* vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
CP.nr.140/22, me 27 janar 2023

GJ Y Q T A R J A
Mirjeta Shala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të parashtrohet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.